

996/997 e – RIVENDOSJA E MATERIALIT

Me krijimin e njësive të reja organizative (bashkimi i njësive ose departamenteve) shpesh shfaqet nevoja, që në këto njësi të vendosen ose rivendosen koleksione të caktuara të materialeve nga njësi të tjera të bibliotekës. Për shkak se e dhëna për vendndodhjen e parë - "të vërtetë" në nënfushën 99Xd, në elementin *l* nuk duhet të ndryshohet, për shënimin e vendndodhjes së re ku është rivendosur materiali përdoret nënfusha 996/997e. Në raste të tilla në nënfushën 996/997q nuk vendoset kodi "5" – *rivendosur*. Në rastin e rivendosjes së materialit nuk bëhet fjalë as për çregjistrimin e materialit e as për dhurim të tij njësisë tjetër, gjithashtu kjo procedure nuk është pjesë e evidencës së huazimit midis departamenteve.

Materiali që rivendoset mund të qëndroj në vendndodhjen e re për një kohë të gjatë dhe në vendndodhjen e parë të kthehet vetëm atëherë, kur atë material biblioteka dëshiron ta çregjistroj – atëherë duhet të fshihet vendndodhja dhe data e rivendosjes në nënfushën 996/997e.

Elementet & gjatësia

NËNFUSHA/ELEMENTI		GJATËSIA
e	Rivendosja e materialit	
E	<i>Nënvendndodhja</i>	10
D	<i>Data e rivendosjes së materialit</i>	8

PËRSHKRIMI I ELEMENTEVE

\E – nënvendndodhja

Shënimi i nënvendndodhjes në elementin *E* verifikohet përmes listës lokale të kodeve të elementit *l* të nënfushës 99Xd.

\D – data e rivendosjes së materialit

Data vendoset në formën "DD.MM.VVVV", ndërsa bazuar në standardin ISO 2014 ajo transferohet në formën "VVVVMDD". Saktësia e vendosjes së datës kontrollohet në mënyrë automatike.

SHEMBUJ

1.

996 □ 2 **d**/Te\μ886.3-313.1 **f**000007857 **e**ENV\D19920601
 (Materiali me nënvendndodhje *Te* është rivendosur në nënvendndodhjen *NV*.)